ENVER HOXHA,

NJË KRYEÇLIRUES DHE KRYEMBROJTËS

I SHTETIT EDHE I KOMBIT TË VET

~~~
~~~

Themi *KRYEÇLIRUES* sepse kur ai e krijoi ushtrinë, shteti shqiptar ishte i pushtuar. Themi *KRYEMROJTËS* sepse ushtria e krijuar dhe e udhëhequr prej tij, e mbrojti shtetin shqiptar deri sa dha frymë më 1985-n. Themi *EDHE I KOMBIT*, sepse, sa qe e fortë ushtarakisht RPSH-ja, më vonë RPSSH-ja, pjesët e paçliruara të Atdheut e kishin një shpresë, e kishin një mbështetje dhe e kishin shpinën të sigurt.

Këto janë tri arsyet që shqiptarët duhet të dinë, kush e krijoi atë ushtri, si u krijua ajo ushtri dhe si qëndroi e fortë dhe e pathyeshme për gjysmë shekulli.

Kur Enver Hoxha erdhi në krye të Partisë Komuniste Shqiptare, Kombi Shqiptar nuk kish ushtri të vetën. Ekzistonte një e quajtur ***ushtri shqiptare***, por ajo ish nën komandën e Shtatmadhorisë Italiane, afërsisht siç është sot ushtria mercenare e Republikës së Shqipërisë nën komandën e Shtabit Qendror të NATO-paktit.

***

Por tash, na duhet të ndalemi pak në HISTORI, sepse sapo e shprehëm një të vërtetë tepër të hidhur dhe jemi të detyruar ta gëlltitim deri në fund këtë të vërtetë: Ushtria e sotme mercenare e Republikës së Shqipërisë, për shkak të rrethanavet dhe për shkak se ne nuk u treguam të shkathët në këto rrethana, komandohet prej tjetërkujt dhe krejt Shqipëria e sotme, ushtarakisht është në dorë të tjetërkujt.

***

Iliro-arbro-shqiptarët, në historinë e tyre shumë të gjatë, në të gjitha kohët, i kanë pasur ushtritë e veta, disa prej tyre nga më të famshmet në botë, por që të gjitha i janë nënshtruar së njëjtës TRAGJEDI: Janë prishur, shkatërruar dhe asgjësuar, për t'u rikrijuar në kohë dhe në pjesë të ndryshme të vendevet tanë dhe për ta bërë e ribërë historinë e vet, herë të lavdishme e herë me më pak famë e lavdi, por gjithmonë me fundin nga më indinjuesit.

Është pothuaj e vërtetuar tashmë që trojanët kanë qenë të gjakut tonë. Por të gjakut tonë duket se kanë qenë edhe Akili e Odiseu, dy më të gjëmshmit shkaktarë të shembjes gjëmëmadhe të atij qyteti, qytet nga më të famshmit, në zanafillë të Antikitetit dhe në të gjitha kohët e mëvonshme. Të mos harrojmë, pra: Shkaktare e drejtpërdrejtë të shembjes së atij qyteti dhe e tjetërsimit të krejt asaj kulture, ka qenë TRADHTIA e Uliksit dhe Akilit, që, me shumë gjasa, them se ishin të të

njëjtit gjak me dardanët e Ilionit. Kush di t'i lexojë dhe analizojë ***Iliadën*** dhe ***Odisenë***, nuk besoj të kundërshtojë në këto që thashë.

Ushtri të forta kishin edhe enkelejtë e Bardhylit, 393-359 p.e.s, por ata, në vend që t'i bashkonin fuqitë dhe të bëheshin të pathyeshëm, qenë të detyruar t'i shkrijnë energjitë e veta në luftëra me sivëllezërit fqinjë e veçanërisht në luftë me maqedonët, prej të cilëvet sulmoheshin herëpas'here.

Aleksandri i Madh, 356-323 p.e.s, sado që thuhet se ushtria e tij ish disakombëshe, është edhe ai një krykomandant i farës sonë, si nga i jati, ashtu edhe nga e ëma.

Prej Aleksandrit, historia na sjell te një tjetër majë ushtarake, te Pirroja i Epirit, 319-272 p.e.s.

Defekti kryesor i të dy këtyre kryeushtarëve, nga më të mëdhenjtë e gjithë botës, mendoj unë, ka qenë komanda dhe administrata e shtetit NË GJUHË TË HUAJ. Sa e vërtetë është kjo, unë nuk mund ta them, por nëse është e vërtetë, pikërisht kjo duhet konsideruar si SHKAKU VENDIMTAR i jetës aq të shkurtër të atyre dy ushtrive.

Ushtri të madhe kish edhe mbreti Agron, që mbretëroi plot 20 vjet, 250-231 p.e.s, por që s'i kish në dorë as veten as ushtrinë, sepse PINTE, dehej dhe, më në fund, vdiq pikërisht nga pija, nga të dehurit. Ishte, pra, një mbret i papërgjegjshëm, si shumë prej prijësvet të Etnitetit dhe të Kombit tonë.

As Teuta, sundimtare në Ilirinë Qendrore më pak se tre vjet, 230-228 p.e.s, s'e pat të dobët ushtrinë, por Dhimitër Farit s'i pëlqeu, as të vihej nën komandën e saj, as të ish një aleat i saji. Atij iu duk "***më e levërdisshme***" aleanca me romakët e huaj, se sa aleanca me rizonasit e me skodrasit e vet. Dhimitër Fari qëndron në të njëjtën linjë të historisë sonë me Akilin e me Uliksin dhe me të mëvonshmit Bato të breukëvet, Ballaban Baderë, Esat Toptan e të tjerë.

Të dy Batot patën një ushtri kryengritëse dyqinmijëshe, vitet 6-9 të e.s, të padëgjuar deri atëherë në lëvizjet çlirimtare të popujvet, por duhej të tradhtonte njëri Bato, ai i breukëvet, që të shpartallohej krejt ajo ushtri dhe Batos së desidiatëvet t'i pritej koka.

Të vijmë tash te Mesjeta. Karl Topia, që sundoi në Arbëri të Mesme në vitet 1374-1388, nuk deshi të pranonte pushtetin as bashkëqeverisjen me Balshën e Dytë, thirri turqit për ta "shpëtuar" prej Balshës dhe e vrau Balshën, me anë të turqvet… Në pllakën e një kishe, përkushtimore e Karl Topisë, fjalët janë gdhendur në TRI GJUHË TË HUAJA, por jo në gjuhën arbërishte! Kurrsesi në arbërisht, se bëhej nami! Topiajt, në rrugë martesash, rrihnin nga francezët, pa iu shmangur krushqivet edhe me sërbët. Ndërsa Balshët martohen kryesisht me gra sërbe, me përjashtim të Balshës së Dytë, i cili do të ish bërë mbret i arbërvet, nëse nuk do ta kish vrarë, me anë të turqvet, Karl Topia. Në dy breza nipërish të sërbëvet, u shkërmoq dhe u shua Principata e Bashëvet. Në të njëjtën kohë, një bijë e Arianitëvet martohet në Sërbi dhe sot mbahet, në një tempull të Frushka Gorës, si një shenjtorja e tyre më e adhuruar. Po Shpatajt e Jugut dhe Muzakët ç'bënin në këta shekuj ekuilibrash të lëkundur?! Të gjithë I kishin ushtritë, por gjuhën për t'u marrë vesh nuk e kishin.

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, zot i një pjese të Arbërisë në vitet1443-1468, e krijoi, më në fund, nga hiçi ushtrinë e vetën, e cila do t'i dilte zot vendit, vërtetësisht dhe fuqimisht. Korri lavdi në krye të asaj ushtrie dhe, mjerisht, pak vjet mbas shuarjes së tij, iu shua edhe ajo ushtri... Nuk kemi dëshmi, përveç një klithme "***Ëmbë tah***!" të Lekë Dukagjinit dhe një ***Formule Pagëzimi***, nëse komanda dhe administrata, në shtetin dhe në ushtrinë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, ishin arbërisht apo disi ndryshe, në ndonjë tjetër gjuhë. Nuk e dime. Do të duhej ta denim.

Edhe pashallarët tanë separatistë, antiosmanë, por tragjikisht të PAÇOSMANIZUAR, i patën krijuar ushtritë e veta. Por edhe ato u shuan bashkë me krijuesit e vet dhe shkaku kryesor, mendoj unë, ish se pashallarët tanë nuk qenë në gjendje t'i SHQIPTARIZOJNË ato ushtri. Ç'komandë dhe ç'flamur kanë përdorur Tepelenasi dhe Bushatasit?!

Edhe ***Lidhja Shqiptare e Prizrenit*** e pat krijuar ushtrinë e vet, por e asgjësuan ***ballabanët*** tanë të shekullit XIX, bashkë me Perandorinë Osmane, e cila, po të ish më e mençur, duhej ta pranonte dhe ta mbronte atë ushtri, si aleaten më të mirë në viset e Evropës për vitet që do të vinin. Në vend që ta pranojë e ta përkrahë, Turqia çoi Dervishpashën, për ta mbytur në gjak ushtrinë tonë, e cila, që në themelet e saj, ishte antisërbe, antibullgare dhe antimalazeze, pra, aleate e natyrshme e Perandorisë Osmane!

Ismail Qemali bëri aq sa mundi, në një katrahurë të pashembullt. Ai e krijoi një ushtri shqiptare, filluar me 500 vetë të Isë Boletinit dhe të të gjithë lebërvet që i kish rretherrotull , pa të cilët, kosovarë dhe lebër, Shqipëria as që do të mund të bëhej shtet... Të gjithë brezat pasardhës të Kombit Shqiptar duhet t'ia dinë për nder përjetë Plakut të pavdekshëm të Vlorës, që diti dhe ia doli të na e krijojë shtetin, mbas aq shekujsh pashtetësie. Ne, pellazgo-iliro-arbro-shqiptarët, kemi pasur shumë shtete në historinë tonë, por, me sa di unë, ky që krijoi Ismail Qemali, është ndër më jetëgjatët dhe unë gjej këtu një nga shkaqet vendimtarë të kësaj jetëgjatie: Ushtritë e këtij shteti u komanduan, më në fund, në GJUHËN SHQIPE!

Atdhetarët që u mblodhën në Lushnjë, prapë, pa forca të armatosura nuk do të mund të bënin asgjë përballë një Evrope Perendimore të pamençur dhe duke pasur anash e rrotull një atdhedorëzues dhe atdhecopëzues, si Esatpashën e Toptanëvet.

Fan Nolit iu shpërbë ushtria që në zanafillë, sepse atij ia kishin ZËNË SYTË "***idealet e demokracisë***", duke mos e lënë të kuptojë as gjënë më elementare: ***Përse krijohet një ushtri?! A nuk krijohet për të vrarë njerëz?!*** E kuptoi dikur gabimin, por ish tepër vonë.

Ahmet Zogu e sajoi një ushtri, me paratë e Sërbisë dhe me bjellorusë. (Unë kam njohur në Ulqin një bjellorus me emrin Arhip, për të cilin thuhej se kish qenë mercenar i Zogut, por kish mbetur andej, se kish pasë frikë të kalonte Bunën.) E armatosi Ahmet Zogu atë ushtri me paratë e Italisë, për të kapitulluar më në fund po prej asaj Italie. Ky është krejt thelbi i historisë së forcës ushtarake të Ahmet Zogut, sado që ai kish mbaruar një shkollë ushtarake.

***

Në këtë vazhdë të historisë së ushtrivet pellazgo-iliro-arbro-shqiptare, do të vinte një ditë edhe ushtria që e krijoi prej hiçit një **ENVER HOXHË**.

Themi "***prej hiçit***", si USHTRI, si forcë ushtarake, përndryshe, nuk duhet të harrojmë që populli ynë ka ekzistuar këtu në të gjithë shekujt, i gatshëm në çdo kohë për t'u armatosur dhe për t'u dalë zot vendit edhe vetes. Gjergj Kastrioti-Skënderbeu pat thënë: ***Lirinë s'jua solla unë, por atë gjeta këtu, midis jush***. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për Enverin: Edhe ai e gjeti lirinë në popullin e vet, në shpirtin liridashës të popullit të vet.

Ajo ushtri, që e krijoi Enver Hoxha, do t'i ngjante në shumë pika ushtrisë zulmëmadhe të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Do t'i ngjante, më në fund, edhe në aspektin e shuarjes së saj, fill mbas vdekjes së themeluesit.

Pikërisht kjo e vërtetë, më se tragjike, nuk duhet dhe nuk mund të kapërcehet pa u trajtuar gjërësisht dhe thellësisht në historiografinë shqiptare, por edhe në ndërgjegjen e shqiptarëvet. Më në fund, Kombi ynë duhet të kuptojë: ***Pse nuk e patën jetën pambarimisht të gjatë ushtritë pellazgo-iliro-arbro-shqiptare e, rrjedhimisht, edhe shtetet që mbroheshin prej atyre ushtrive?!***

***

Ndërkaq, unë po sjell këtu, thjeshtë për informacion, një PASQYRË FARE TË SHKURTËR të asaj ushtrie, krijuar prej Enver Hoxhës, mëkëmbur mbi sakrifica e mbuluar me lavdi, jeta e së, falë përkushtimit dhe aftësivet të krijuesit të saj, si dhe shpirtit përjetësisht lirikërkues të Kombit tonë, ia doli të mbetet zonjë në vendin e vet për thuajse gjysmë shekulli.

Nëse dikush do të më thotë, siç edhe është thënë, se Enver Hoxha ka gënjyer sa herë ka deklaruar që në Luftën Nacionalçlirimtare Shqiptare kanë rënë 28 mijë dëshmorë dhe nëse kjo vërtetohet me DOKUMENTE, mua do të më vijë keq dhe do të ndjehem i zhgënjyer, por Enveri prapë do të mbetet po aq i rëndësishëm në historinë e Kombit Shqiptar.

Nëse dikush do të më thotë, siç edhe është thënë me mijëra herë, se Enver Hoxha "***ka vrarë njerëz të pafajshëm***", unë së pari do të pyes: ***E përse do ta bënte një gjë të tillë?! A pak kish Enveri njerëz të fajshëm për të vrarë?!*** Dhe nëse vërtetohen ata pohime me shifra dhe me fakte, mua do të më vijë keq, por Enveri prapë do të mbetet po aq i rëndësishëm në historinë e Kombit Shqiptar.

Unë nuk jam nga ata që, kur flitet për një shenjtor, nuk e përfytyrojnë dot që ai mund të ketë pasur edhe morra.

***

Luftën kundër pushtuesvet fashistë italianë populli shqiptar e kish filluar qysh në orët e para të atij pushtimi. Përfaqësuesi i asaj lufte është Mujo Ulqinaku, sado që nuk ish vetëm ai, që u vra në përballjet e para me agresorët.

Si formacion i parë luftarak i organizuar me synim çlirimin prej pushtuesvet, ka qenë Çeta e Pezës, e formuar në vitin 1940 dhe e komanduar prej atdhetarit të njohur jokomunist, Myslym Peza. Ish krijuar, pra, ajo çetë më se një vit para se të themelohej Partia Komuniste Shqiptare. Mirëpo, që nga gushti 1941, gati 3 muaj para se të themelohej PKSH-ja, Çeta e Pezës politikisht filloi të udhëhiqej nga komunistët.

Në vitin 1942, në territorin e ish-shtetit shqiptar, u krijuan edhe 22 çeta partizane të udhëhequra politikisht prej komunistëvet atdhetarë, në krye të të cilëvet qëndronte Enver Hoxha. Ndërsa në vitin 1943 janë krijuar dhe hedhur në luftë kundër pushtuesvet italianë, gjithnjë nën udhëqjen e PKSH-ë, edhe 39 çeta të tjera.

Pra, para se t'i hyhej krijimit të formacionevet më të mëdhenj, batalionevet, brigadavet, divizionevet dhe korparmatavet, në territorin e ish-shtetit shqiptar kanë vepruar 62 formacione më të vegjël se batalioni, që quheshin ***çeta***, që komandoheshin prej atdhetarësh, jokomunistë apo komunistë, por që ideologjikisht udhëhiqeshin nga Partia Komuniste nëpërmjet celulavet të asaj partie dhe komisarëvet.

Në të njëjtën kohë, në ish-shtetin shqiptar të pushtuar prej fashistëvet italianë e, nga shtatori i vitit 1943, prej nazistëvet gjermanë, kanë vepruar edhe formacione luftarakë që nuk udhëhiqeshin prej komunistëvet. Këta ishin **legalistët (zogistët**), **ballistët,** si dhe ndonjë formacion vendor, udhëhequr prej ndonjë prijësi tradicional, që nuk lidhej me asnjërin ose që lidhej herë me njërin e herë me tjetrin.

Më të shumtë në numër dhe më me influencë kanë qenë **BALLISTËT**. Ata, duke qenë se e mirëpritën, me të drejtë, faktin që Italia Fashiste dhe Gjermaia Naziste i patën prishur Vendimet e Londrës dhe të Versajës për copëtimin e Shqipërisë, sado që nën okupim, gjetën shumë përkrahje në popull. Qëndrimi i ballistëvet në kohën e pushtimit fashisto-nazist mund të krahasohet me qëndrimin e pushtetarëvet tanë të sotëm ndaj BE-së dhe SHBA-së. SHBA-ja dhe BE-ja po mirëpriten sot thuajse pa rezerva prej krejt Kombit Shqiptar, pikërisht sepse ndihmuan për t'u çliruar prej sllavëvet një pjesë e Shqipërisë, sado që jo krejt dhe sado që pavarësia jonë, e të dy shtetevet tanë, është tepër e kushtëzuar dhe tepër e kufizuar.

Por ballistët patën në punën e tyre, në strategji e në organizim, një varg të metash vendimtare, të cilat pashmangshëm do t'i çonin në disfatë shumë të shpejtë.

E para, ballistët **nuk ditën të bënin kthesë** në momentin kur u pa se Boshti po e humbte luftën. Natyrisht, nuk ish lehtë të bëhej kthesa. Por kur u kuptua në të gjithë botën se Boshti Itali-Gjermani-Japoni po dështonte, ballistët, jo vetëm këta në ish-shtetin shqiptar, por që të gjithë, të bashkuar në krejt territorin e Shqipërisë, nën një komandë të vetme qendrore, duhej të kishin kërkuar zyrtarisht prej anglezëvet dhe prej amerikanëvet miratimin pa rezerva të **BASHKIMIT KOMBËTAR**. Nuk dimë të ketë ndodhur ashtu, megjithëse bënin zhurmë të madhe me gazetën e tyre „***Bashkimi kombëtar***“. Si mund të realizohej bashkimi kombëtar pa miratimin edhe të Aleatëvet, sidomos atyre perendimorë?! Le që ne nuk e dimë: A ekzistonte një ***Shtab Qendror i Ballit Kombëtar***, që t'i përfshinte të gjitha forcat e aramatosura të asaj organizate, në të gjithë territorin e Shqipërisë, nga Preveza në Mitrovicë dhe nga Kumanova në Vlorë?! Dhe pyetja historike shtrohet kështu: A e lanë në baltë Aleatët Perendimorë ***Ballin tonë Kombëtar***, apo e la vetë ***Balli*** veten në baltë, pa iu drejtuar fare Aleatëvet pikërisht me platformën e bashkimit të krejt Kombit Shqiptar në një shtet të vetëm?!

Politika rutinë antishqiptare e anglo-amerikanëvet është FAKTORI KRYESOR I JASHTËM, i cili e dëmtoi rëndë Kombin Shqiptar në Luftën e Dytë Botërore. Në qoftë se U.Çërçilli e F. Ruzvelti do t'i kishin shpallur të pavlefshëm vendimet e Konferencës së Londrës dhe të Mbledhjes së Versajës, copëtuese të Shqipërisë, dhe t'ua komunikonin zyrtarisht qëndrimin e vet, si Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, ashtu edhe Komandës së Përgjithshme të Ballit Kombëtar, po edhe aleatëvet jugosllavë dhe grekë, situata në krejt Shqipërinë, rrjedhimisht në krejt Gadishullin e Ilirikut, do të qe sot shumë më e favorshme. Popujt e këtij gadishulli do ta kishin gjetur më në fund qetësinë e shumëdëshiruar.

E dyta, ballistët, në **organizimin e tyre të brendshëm**, nuk e zbatuan dot, madje nuk e vunë fare në jetë DISIPLINËN USHTARAKE të luftës. Në formacionet e armatosur të ballistëvet nuk ka pasur disiplinë të fortë ushtarake. Mjafton të përmendim vetëm një fakt: Nuk dimë të ketë ndodhur asnjë dënim, qoftë i eprorëvet, qoftë i ushtarëvet të thjeshtë, as me burgim, as me pushkatim. A mund të egzistojë disiplinë ushtrie në kohë lufte pa gjyqe ushtatrakë dhe pa dënime me pushkatim?! Si rrjedhojë, sjelljet e ballistëvet, të armatosur gjer në dhëmbë, ishin të papëlqyeshme në popull dhe shumë herë të dhunshme e të padurueshme. Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore që ***Balli***, nga dita në ditë, e humbi autoritetin në masën

e fshatarëvet dhe të qytetarëvet. Ballistët qenë shndërruar në kapadainj dhe në plaçkitës të popullit të vet.

E treta, ***Balli Kombëtar*** shqiptar nuk kishte një udhëheqje konkrete ideologjike. Ekzistonte ideja kombëtare, por njerëz konkretë, të ngarkuar institucionalisht për ta propaganduar dhe zbatuar atë ide, ***Balli Kombëtar*** nuk ka pasur.

Shumica e ushtrivet të botës i kanë institucionet e vet ideologjikë. Në ushtrinë e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ishin klerikët katolikë që i propagandonin, ndër ushtarët dhe në popull, idetë e asaj lufte. Shembull është arqipeshkvi Pal Engjëlli, por edhe Gjergj Pelini, Gazujt e shumë të tjerë, për të ardhur deri te Marin Barleti, i cili e përjetësoi si askush tjetër Luftën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Priftërinjtë katolikë, disa edhe të unijatizuar, kanë qenë „***komisarët***“ e ushtrisë së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.

Në Revolucionin Francez mund të kujtojmë figurën e Simurdenit, ***komisar*** në ushtrinë revolucionare franceze, pasqyruar si i tillë në një vepër të Viktor Hygoit.

Në vitet e ***Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*** ka ndodhur një mrekulli në institucionin tonë ideologjik kombëtar: Me dhjetëra klerikë **myslimanë** u rreshtuan në të njëjtin front me klerikët tanë të krishterë, katolikë e ortodoksë, kundër Perandorisë Osmane. Hoxhët tanë të atyre viteve predikonin kështu nëpër xhamira: „***Kush bie shehit për vatanin, qoftë edhe kundër kalifit, shkon në xhenet!***“

Balli ynë ***Kombëtar*** as që i hyri punës për të pasur një të tillë institucion, i cili të qëndronte sipër organevet të komandimit, siç qëndronin komisarët komunistë mbi komandantët, në Ushtrinë Nacionalçlirimtare. Kjo solli që komandantët e ***Ballit*** të bënin ç’të donin në ushtri e në popull dhe të mos i mbikqyrte as ndëshkonte askush.

Së katërti, i ndodhur përballë Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të organizuar dhe udhëhequr prej komunistëvet, që s’e mohuan asnjëherë aspiratën kombëtare, ballistët duhej të kishin gjetur kurajon për t’iu bashkuar asaj ushtrie, pa kërkuar që të komandonin, sepse realisht ata s’kishin të drejtë të komandonin në një ushtri që e kish krijuar tjetërkush dhe që dukshëm po korrte fitore.

Ballistët, konkretisht delegatët e kryesuar nga Mit’hat Frashëri në Mbledhjen e Mukjes, gusht 1943, duhej t‘i kishin pranuar komandën dhe disiplinën ushtarake të

Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke insistuar vetëm në një pikë: ***Të mos sakrifikohej ideali kombëtar i bashkimit as për hir të ideologjisë komuniste dhe as për hir të cilësdo ideologji tjetër.***

Mirëpo, në Mbledhjen e Mukjes nuk morën pjesë, as nga ana e ***Ballit***, as nga ana e forcavet antifashiste, përfaqësues të Kosovës, të Rrafshit të Dukagjinit, të Tetovës e visevet të tjerë të asaj ane, të Kosturit, të Çamërisë, të Rozhajës, Plavës, Tuzit, Tivarit dhe Ulqinit. Pse ndodhi ashtu?! Pikërisht në këtë pikë duhen përqëndruar analizat e historianëvet tanë dhe e gjithë kjo besoj se do të na çonte në konkluzionin se, ndër udhëheqësit tanë të asaj kohe, edhe te ballistët, edhe te komunistët, mungonte PJEKURIA POLITIKE E KOHEZIONIT GJITHKOMBËTAR.

E njëjta mungesë pjekurie gjithkombëtare po mungon edhe sot në të gjitha strukturat politike shqiptare, që nga brigjet e Ibrit e të Moravës e deri në brigjet e Adriatikut e Jonit. Një kohezion të tillë nuk mund ta realizojë askush tjetër, përveç një institucioni ideologjik gjithkombëtar, të cilin unë e kam quajtur ***Përkujdesja Gjithshqiptare.*** Nuk ka tjetër rrugë.

Sa u përket **ZOGISTËVET**, ata ishin vetëprivuar nga mundësia për të rriardhur në pushtet, qysh prej ditës kur mbreti „***i të gjithë shqiptarëvet***“ Ahmet Zogu ishte larguar nga mbretëria e vet, duke e lënë Atdheun nën mëshirën e pushtuesvet. Është i pamohueshëm pohimi analitik: Sikur mbreti Ahmet Zog t’i kish rezistuar agresionit fashist me armë, qoftë edhe duke u vrarë vetë në mbrojtje të Atdheut, situata gjatë Luftës së Dytë dhe mbas Luftës së Dytë, jo vetëm në Shqipëri, por në krejt Gadishullin e Ilirikut, mund të ishte krejt ndryshe. Së pari, një akt i tillë do të kish tërhequr fuqishëm vëmendjen e gjithë botës dhe së dyti, në Shqipëri nuk do të mund të krijohej Partia Komuniste dhe, rrjedhimisht, në Shqipëri, dua të them në krejt Shqipërinë, do të kish mbetur në fuqi rendi kushtetues monarko-kapitalist.

Gjithsesi, derisa Ahmet Zogu e kish vënë mbi kokë kurorën e mbretit, ai duhej ta kish mbrojtur atë kurorë me jetën e vet. Ndryshe, të mos e kish shpallur veten mbret.

Në anë tjetër, të ish larguar Enver Hoxha nga vendi i vet, në ata vite lufte, qoftë edhe përkohësisht, a do ta kish fituar luftën?! Pa dyshim që jo! Por ai nuk u largua.

Madje, ishte në terren, gjatë gjithë vitevet të Luftës, pa pëjashtuar mundësinë se edhe mund të vritej.

Jo vetëm në Shqipëri, por në asnjë vend të botës, monarkët që e braktisën monarkinë e vet në kohën e Luftës së Dytë, nuk mundën të kthehen më në fronet e vet. Në të kundërt, ata monarkë që nuk e braktisën vendin në kohë të Luftës së Dytë, mundën të qëndrojnë në fron, me gjithë konservatorizmin që i karakterizonte. Shembull është mbretëresha e Anglisë. Ndërsa Londra po bombardohej, ajo ndenji aty. Nëse do të ish larguar, siç edhe e këshilluan, ajo nuk do të mund të kthehej kurrë më në fronin e asaj mbretërie dhe ka mundësi që edhe Ishujt Britanikë të ishin pushtuar, siç u pushtua Franca. Edhe në Japoni monarkia u mbajt më këmbë, sepse mbreti nuk e lëshoi vendin e vet as në ditët kur Japonisë iu hodhën bombat bërthamore.

Prandaj zogistët tanë të sotëm e kanë kot, kur mundohen ta justifikojnë ikjen e Ahmet Zogut nga Shqipëria. Monarkistët nuk kanë të ardhshme në Shqipëri. Unë kam pasur një mik timin, monarkist i betuar, i cili e pohonte me dhimbje këtë të vërtetë, tashmë të kushtëzuar nga vetë historia.

***

Ndërkohë, Enver Hoxha qëndroi në krye të ushtrisë që e kish krijuar vetë, me bashkëmendimtarët e vet dhe me atdhedashës të tjerë, përgjithësisht vizionarë të kthjellët, dhe ky është njëri nga faktorët që ai arriti të mbahet në pushtet edhe mbas Luftës së Dytë. Në maj-qershor 1943, të 62 çetat partizane, që i përmenda më parë, u organizuan në batalione. Deri në fund të korrikut 1943, në krejt territorin e ish-shtetit shqiptar, numëroheshin 19 batalione.

Është interesant t'u hidhet një sy edhe një pjese të emravet që mbanin çetat partizane dhe batalionet partizanë. Çetat: „***Koto Hoxhi***“, „***Çerçiz Topulli***“, „***Hajredin Tremishti***“, „***Avni Rustemi***“, „***Selam Musai***“, „***Musa Fratari***“, „***Kanan Maze***“, „***Zigur Lelo***“, „***Sali Murati (Vranishti)***“, „***Hodo Zeqiri***“, „***Halim Rakipi***“, „***Toto Bolena***“, „***Sabaudin Gabrani***“. Batalionet: „***Ismail Qemali***“, „***Naim Frashëri***“, „***Qamil Panariti***“, „***Themistokli Gërmenji***“, „***Ali Këlmendi***”, “***Fuat Bababni***“,“ ***Halim Xhelo***“, „***Perlat Rexhepi***“, „***Riza Cerova***“. Shumica janë emra atdhetarësh jokomunistë, vetëm një pjesë e tyre janë emra militantësh komunistë të Paraluftës dhe fare pak të kohës së Luftës. Bie në sy edhe fakti që shumica e këtyre

emrave janë nga Jugu, por kjo kurrsesi nuk shpreh as farë fobie, as ndonjë „***mbisundim keqdashës***“ të Jugut ndaj Veriut. Kjo është thjeshtë një dëshmi e kontributit që ka dhënë Jugu ynë në këtë pjesë të historisë sonë.

Midis këtyre formacioneve është për t'u përmendur ***Batalioni*** „***Çamëria***“, në përbërje të cilit kishin hyrë tri çeta: „***Hoxhë Tahsini***“, „***Alush Take***“ dhe „***Atë Stath Melani***“. Vetëm emrat e atyre tri çetave dhe emri i vetë batalionit, për nga domethënia, meritojnë një analizë të hollësishme. Megjithëse nuk veproi në krejt Çamërinë, simbolikisht ai batalion përfaqësonte edhe pjesën e Çamërisë, pushtuar nga Greqia qysh prej fillimshekullit.

Nga data 15 gusht 1943 deri më 29 nëntor 1944, në një hark kohor prej 15 muajsh, janë krijuar në territorin e krejt ish-shtetit shqiptar plot 27 brigada, efektivat e të cilavet përbëheshin me nga më shumë se një mijë luftëtarë. Një e treta e atyre brigadave janë krijuar në hapësirën nga Shkumbini në Tropojë, kurse dy të tretat qenë formuar në jug të Shkumbinit, pjesë që i takojnë Shqipërisë Jugore, por pa i përfshirë Çamërinë, Janinën, Konicën etj. Kjo, natyrisht, shpjegohet me rrethanat historike, por kurrsesi nuk mund të lihet jashtë vëmendjes së studiuesvet, sado që në asnjë rast nuk mund të thuhet që „***komunizmi erdhi nga Shqipëria e Jugut***“. Njëkohësisht, nuk duhen lënë jashtë vëmendjes edhe brigadat shqiptare antifashiste e antinaziste që u krijuan në Kosovë e në pjesë të tjera të Shqipërisë, mbetur nën Jugosllavi. Të gjitha ato brigada luftëtarësh shqiptarë i takonin Veriut të Shqipërisë. Pra, nuk mund të flitet kurrsesi, as në kohën e Luftës së Dytë Botërore e as më vonë, për ndonjë ndarje Veri-Jug. Ndarja e përçrja Veri-Jug e Jug-Veri, ashtu si edhe ndarja e përçarja mbi bazë besimi, kanë marrë fund ndër shqiptarët qysh në kohën e Rilindjes sonë Kombëtare. Ata që i bëjnë këto ndarje, janë thjeshtë mbeturina, produkt lloj-lloj propagandash antishqiptare.

Më 28 maj 1944, katër ditë mbas Kongresit të Përmetit, filloi krijimi i divizionevet. (Që nga data 24 maj 1944, nuk do të themi më ***ish-shteti shqiptar,*** por do të themi *RPSH* ose *RPSSH*.) Deri më 18 nëntor 1944 janë krijuar gjithsej 8 divizione të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe, më në fund, u kalua në formacionet e korparmatavet, njësitë më të mëdha të asaj ushtrie, krijuar, veç tjerash, edhe me meritën madhore të Enver Hoxhës. Efektivi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, në fund të vitit 1944, arriti në 70 mijë. Le të thotë kush të dojë çfarë të

dojë, Enver Hoxhës, për këtë periudhë të historisë sonë, por, siç do të shohim, edhe për periudhën deri në vitin 1985, i takon PIEDESTALI MË I LARTË.

Ballistët, zogistët, madje edhe shumë ish-komunistë, të cilët kishin përjetuar ndonjë dënim apo thjeshtë ndonjë pakënaqësi personale, kanë folur sa kanë mundur kundër veprimtarisë së Enver Hoxhës, përfshirë aty edhe ushtrinë që e kish krijuar ai dhe në krye të së cilës ka qëndruar pothuaj gjysmë shekulli. Kanë folur e shkruar madje kundër Enver Hoxhës, gjithfarë individësh, moralisht të paformuar apo të deformuar, edhe thjeshtë për të përfituar ndonjë gjë, ndonjë post, ndonjë dorë para apo … për t'u lavdëruar prej dikujt.

Por pyetja më e thjeshtë që mund të bëhet, është kjo: ***Pse nuk e krijuan vetë një ushtri shqiptare të fuqishme, këta që flasin kundër krijuesit të asaj ushtrie?! Pse nuk e mundën Enver Hoxhën ballistët apo zogistët, por pritën të vdesë ai, pastaj të bëhen pjesë mjerane e qeverisjes, e më së keqes qeverisje që Kombi Shqiptar ka njohur deri më sot!? Enveri i krijoi 8 divizione, këta pse nuk i bënë 18***?!

Është njëlloj sikur të bëjnë ndeshje dy boksierë të të njëjtit qytet dhe i munduri të fajsojë gjithë jetën mundësin dhe të mos pushojë së foluri keq për të edhe mbasi fitimtari të ketë vdekur. Një boksier i tillë, që nuk sheh gabimet në radhë të parë te vetja, kurrë nuk mund t'i fitojë, as ndeshjet, as autoritetin. Një boksier i tillë është moralisht i asgjësuar, edhe në sytë e tifozëvet të vet, sado të verbër të jenë ata në tifozllëkun e tyre.

Një paralelizëm të ngjashëm po e bëjmë edhe me dy ekipe futbolli të të njëjtit vend. Ai ekip futbolli që akuzon pa pushim kundërshtarin dhe nuk bën analiza të gabimevet të vet dhe që nuk vendos disiplinë të hekurt brenda vetes, kurrë nuk do të mund ta shohë veten fitues.

Po dalin tani e po i shpallin heronj disa krerë krahinash që e patën kundërshtuar me armë ushtrinë fitimtare të Enver Hoxhës, duke i cilësuar ata si "***patriotë të mëdhenj***" dhe duke u ngritur monumente. Është e vërtetë që ka në historinë e popujvet atdhetarë martirë, të cilët, me vdekjen e vet, paralajmërojnë një të ardhshme më të mirë dhe më të ndritur. Por, në dukurinë që po përmend, nuk kemi të bëjmë fare me martirë të tillë, sepse ata nuk kanë përfaqësuar kurrfarë progresi. Përkundrazi, ata janë mbrojtës të konservatorizmit dhe të regresit. Si të tillë, ata nuk meritojnë t'u ngrihen monumente.

Monumentet duhet t'i ngrihen Enver Hoxhës dhe kjo, siç duket, më parë ka për të ndodhur në Itali, në Francë, në Angli, në SHBA, pastaj do t'i ngrihen monumente në viset që sot gjenden jashtë Republikës së Shqipërisë dhe, më në fund, do t'i ringrihen në Tiranë, në Gjirokastër e në Shkodër. Kuptohet, ky është thjeshtë një parashikim dhe dihet që parashikimi asnjëherë nuk vihet në jetë pikë për pikë.

Në shpirtin e popullit, Enver Hoxha vazhdon të jetojë edhe pa monumente, ngjashëm me Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, që na e dëshmon aq bukur Fran Bardhi.

Lidhur me kalimin e formacionevet të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare në Rrafshin e Dukagjinit dhe në vise të tjerë të Shqipërisë, pushtuar që në 1878-n e 1913-n prej sllavëvet të jugut, është folur e përfolur, edhe mbarë, edhe mbrapsht. E gjithë kjo ngjarje jo e vogël ka nevojë të trajtohet objektivisht dhe t'I lëmë përrallat boshe.

Brigada III dhe ***Brigada V*** e kanë kaluar kufirin shqiptaro-shqiptar që në tetor 1944. Pak më vonë ka kaluar ***Brigada XXV*** dhe, nga dhjetori 1944 deri në janar 1945, kanë vepruar në ata vise ***Divizioni V*** dhe ***Divizioni VI***.

Dihet që ata formacione, ato njësi të mëdha ushtarake të shtetit shqiptar, e kanë kaluar kufirin me miratimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrië Nacionalçlirimtare Jugosllave dhe me urdhër të Enver Hoxhës, Komandant i Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

Por mbetet për t'u parë dhe për t'u trajtuar: A ka qenë kërkesë e jugosllavëvet apo kërkesë e jona? Nëse kërkesa ka qenë prej palës jugosllave, do shtruar pyetja: Pse? Po kështu edhe në rast se kërkesa ka dalë prej anës shqiptare. Kush ka propozuar dhe si është arsyetuar? Cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe çfarë PRAPAMENDIMI mund të ketë pasur secila palë?

Përfundimisht do parë: A ish veprim i drejtë dërgimi i formacionevet ushtarakë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare atje, pa u marrë një vendim i qartë se ç'do të bëhej me ato pjesë të Shqipërisë mbasi të mbaronte Lufta? Dhe në vazhdim: A ish e drejtë tërheqja e atyre formacioneve nga ato pjesë të Shqipërisë? Ç'mund të bëhej në ata raste? Ç'duhej bërë e ç'nuk u bë ashtu si duhej?

Në lidhje me këtë ngjarje të rëndësishme duhet parë edhe qëndrimi i Aleatëvet Perendimorë, i anglo-amerikanëvet, si dhe i autoritetevet apo i përfaqësuesvet të Bashkimit Sovjetik, sepse, kur kalon një ushtri një kufi shtetëror, duhet të ketë doemos edhe një reagim apo qëndrim të secilës palë të interesuar.

Po marr disa shembuj: Për të zbarkuar Forcat e Aleatëvet Perendimorë në Gjirin e Biskajës ka pasur një vendim, një urdhër ushtarak dhe një arsyetim përkatës. Po kështu edhe për operacionet ushtarakë të Perendimorëvet në Afrikën Veriore, në Itali dhe në Greqi.

Një vendim, një urdhër dhe një arsyetim, ka pasur edhe në rastin kur njësitë e ushtrisë angleze tentuan të zbarkonin në brigjet e Sarandës tashmë të çliruar. Fill mbasi forcat angleze nuk u lejuan të zbarkonin në brigjet e Sarandës, ka ekzistuar një urdhër që forcat angleze të zbarkonin në bregdetin e Tivarit. Misioni ushtarak anglez, me jo pak efektivë, gjendej në Tivar kur ndodhi Masakra kundërshqiptare e Tivarit, masakër me rreth katër mijë viktima. Pak muaj më parë kishin ndodhur bombardimet e aviacionit anglez, mbi Ulqin, mbi Podgoricë, mbi Gjakovë dhe mbi Pejë, edhe ata bombardime, me jo më pak se katër mijë viktima shqiptare. Asgjë s'është bërë pa vendimet me shkrim, pa urdhërat me shkrim dhe pa arsyetimet përkatës.

Në anën tjetër, kur Ushtria Sovjetike ka hyrë në Rumani, në Bullgari dhe në shtete të tjerë të Evropës Lindore, përfshirë aty edhe pjesën verilindore të Jugosllavisë, doemos ka pasur vendime, urdhëra dhe arsyetime të shtabevet përkatës, si të Ushtrisë Sovjetike, ashtu edhe të ushtrivet të vendevet ku po hynte Ushtria Sovjetike. Ka pasur doemos, lidhur me të gjitha këto, edhe një qëndrim, bashkëveprim apo kundërveprim të Aleatëvet Perendimorë.

Ç'të dhëna kemi lidhur me reagimet, qoftë të Perendimorëvet, qoftë të Lindorëvet, kur formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare po kalonin kufirin e shtetit të tyre "të ligjshëm"? Misionet anglo-amerikanë, që ndodheshin në terren dhe që mbanin lidhje të vazhdueshme me qendrat e veta, pse nuk i thanë Enver Hoxhë: Qëndro në Kosovë, se flasim ne me Titon?!

E gjithë kjo ka nevojë të shqyrtohet mbi bazën e dokumentevet, duke mos pasur prirjen t'i ngarkohet faji vetëm Enver Hoxhës. Fajet apo gabimet duhet të shpërndahen mbi të gjithë aktorët që morën pjesë në atë luftë të madhe, simbas

forcës ushtarake dhe potencialit politik e diplomatik që kish secili prej tyre, sepse vetëm kështu mund të nxirren mësimet e duhur, si për kohën e sotme, ashtu edhe për brezat që do të vijnë mbas nesh.

Gjykimi im, me kaq informacion sa kam deri tash, është që, gabimin apo edhe fajin që ***ÇËSHTJA SHQIPTARE*** mbeti pa u zgjidhur në fundin e Luftës së Dytë Botërore, e kanë anglezët, konkretisht U. Çërçilli, dhe mbas tyre edhe amerikanët, konkretisht F. Ruzvelti. Pjesën e vet të gabimit (Jo të fajit!), doemos, e ka edhe Enver Hoxha, por pa i çliruar gabimesh as ballistët dhe as shqiptarët e përtejkufijvet, të cilitdo orientim të kenë qenë.

***

Më 24 janar 1945, Enver Hoxha boton një artikull te gazeta „***Bashkimi***“, në të cilin sqarohet rëndësia që ka NJË USHTRI E LIDHUR NGUSHTË ME POPULLIN E VET. Aty flitet hollësisht mbi dallimet thelbësorë midis disa ushtrive shqiptare të mëparshme dhe Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila tashmë do të merrte detyrën jo të fitimit, por të ruajtjes së lirisë, me emërtimin ***Ushtri Kombëtare***. Sigurisht, nga pikëpamja jonë e sotme, ajo ushtri nuk mund të quhej ***Ushtri*** *KOMBËTARE*, sepse nuk vepronte në hapësirat e krejt Kombit, megjithatë, tiparet e asaj ushtrie ishin qartësisht të lidhur me interesat e Kombit.

Më 10 korrik 1945, Enveri, si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë, tashmë të emërtuar “***KOMBËTARE***”, përkthim në shqip i fjalës *NACIONALE*, lëshon një urdhër dite, ku përsëri bën sqarime mbi lidhjet e ngushta të asaj ushtrie me popullin. (Vep.3, f.63-66)

Më 26 mars 1945 Enveri merr edhe në Kuvendin Popullor emërimin zyrtar ***Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare***. (Vep.3, f.320-321)

***

Tani e tutje unë do të merrem kryesisht me regjistrimin e titujvet, ku Enver Hoxha ka folur për ushtrinë dhe kjo do t’i mjaftojë lexuesit për të kuptuar sa shumë u përpoq ai njeri, që RPSH-ja, e më vonë RPSSH-ja, të kish një USHTRI sa më të fuqishme për të mbrojtur jo vetëm shtetin ekzistues shqiptar, por, në rrethana që do të siguronin jo humbje, por fitore, për t’u dalë zot edhe pjesëvet të tjera të Shqipërisë.

1.Urdhër dite me rastin e përvjetorit të katërt të krijimit të Ushtrisë Popullore (Shqiptare), 10 korik 1947. (Vep.4, f.79-81)

2.Urdhër dite me rastin e përvjetorit të katërt të Armës së Ndërlidhjes, 22 qershor 1948. (Vep.4, f.488-490)

3.Urdhër dite me rastin e Festës së 10 Korrikut, përvjetorit të Ushtrisë Popullore (Shqiptare), 10 korrik 1948. (Vep.4, f.491-495)

4.Fjala e mbajtur përpara popullit dhe repartevet ushtarakë të garnizonit të Tiranës, me rastin e përvjetorit të pestë të krijimit të Ushtrisë Popullore (Shqiptare), 10 korrik 1948. (Vep.4, f.496-501)

5.Urdhër dite me rastin e përvjetorit të pestë të Armës së Artilerisë, 18 tetor 1948. (Vep.4, f.505-510)

6.Në Kongresin e Parë të PKSH-së, 8 nëntor 1948, ka një kapitull që flet kryekëput për ushtrinë, "***Ushtria Kombëtare***", dhe një kapitull për Armën e Sigurimit, "***Arma e Sigurimit të Shtetit***". (Vep.5, f.453 dhe 457)

7.Fjala e mbajtur me rastin e mbylljes së kursit të shtatë për oficerë, 7 janar 1949. (Vep.6, f.1-5)

8.Fjala e mbajtur në fshatin Bratilë të Gramshit, para ushtarëvet dhe popullit me rastin e inaugurimit të punimevet për ndërtimin e rrugës Gramsh-Lozhan, 2 mars 1949. (Vep.6, f.38-51)

9.Letër dërguar oficerëvet pensionistë, shokëvet Riza Kodheli dhe Ahmet Staravecka me të cilën i falenderon për gatishmerinë e shfaqur për të luftuar në mbrojtje të kufirit, 26 gusht 1949. (Vep.6, f.255-256) (Kishin ndodhur të quajturit ***Provokacione të Gushtit***. Në të vërtetë, ishte një sulm i ushtrisë monarko-fashiste greke, për të pushtuar pjesë të tjera të Shqipërisë Jugut. Themi ***pjesë të tjera***, sepse Greqia e kish pushtuar thuajse gjysmën e Shqipërisë së Jugut qysh më 1913-n. Përgjigjja shqiptare ishte ajo që duhej. Gj.D.)

10.Fjala e mbajtur para ushtarëvet të plagosur në provokacionet e monarko-fashistëvet grekë kundër RPSH-së, 2 shtator 1949. (Vep.6, f.259-266)

11.Urdhër dite me rastin e përvjetorit të pestë të Çlirimit, 29 nëntor 1949. (Vep.6, f.412-414)

12.Partia në luftë për mbrojtjen e paqes, të pavarësisë dhe të integritetit të Atdheut (pjesë nga fjalimi me rastin e 10-vjetorit të themelimit të PPSH-së), 8 nëntor 1951. (Vep.8, f.463-476)

13.Të forcojmë më shumë punën në organet e Sigurimit të Shtetit, 15 nëntor 1951. (Vep.8, f.490-495) (Është hedhur shumë baltë mbi organet e ***Sigurimit të Shtetit Shqiptar***. Shumë lloje baltërash! Po pse?! Sepse ai shërbim sekret E SIGURONTE SHTETIN SHQIPTAR! Gj.D.)

14.Mbi punën e Partisë në ushtri, 23 maj 1952. (Vep.9, f.313-316) (Sot është hedhur në treg slogani demagogjik mbi „***apolitizimin e ushtrisë***“. Me fjalë të tjera, ushtaraku i sotëm nuk duhet të ketë mendje. A është e mundur që njeriu, thjeshtë sepse është i veshur me uniformë, të pushojë së menduari, midis tjerash, edhe ***për politikën***, në një kohë kur i kërkohet të mendojë për politikën edhe një drogaxhiu, të paktën në ditën e zgjedhjevet?! Gj.D.)

15.Mbi punimin e rezolucionevet të Kongresit II të PPSH-së në aktivet dhe organizatat bazë të Partisë në terren dhe në ushtri, 27 qershor 1952. (Vep.9, f.353-362)

16.Fjala para oficerëvet që morën pjesë në lojën operative të armatës, 30 korrik 1952. (Vep.9, f.396-415)

17.Fjala para disa oficerëve që u graduan general-majorë, 30 gusht 1952. (Vep.9, f.480-482)

18.Letër dërguar organizatavet të Partisë në terren dhe në ushtri mbi mungesë vigjilence të theksuar në organizatën bazë të Partisë në NBSH “8 Nëntori” Sukth, 8 dhjetor 1952. (Vep.10, f.199-208)

19.Udhëzime dërguar organizatavet të Partisë në terren dhe në ushtri mbi disa rregulla për paraqitjen e komunistëvet në mbledhjet e Partisë, 8 dhjetor 1952. (Vep.10, f.207-210)

20.Urdhër dite me rastin e 10-vjetorit të themelimit të Ushtrisë Popullore, 10 korrik 1953. (Vep.10, f.495-497)

21.Puna me kuadrin në ushtri nuk është vetëm vendosja në detyra e oficerëvet apo e nënoficerëvet, por është një punë e tërë shkencore, 7 shtator 1953. (Vep.11, f.28-33)

22.Mbi disa gabime seriozë të Panajot Plakut, 12 shtator 1953. (Vep.11, f.34-40) (Ushtarak i lartë dhe anëtar i Komitetit Qendror të PPSH, i cili pak më vonë u arratis në Jugosllavi dhe u dorëzoi organevet shtetërorë të Jugosllavisë shumë të dhëna sekrete që lidheshin me ushtrinë shqiptare. Gj.D.)

23.Mbi kritikën dhe autokritikën në ushtri, 7 dhjetor 1953. (Vep.11, f.122-127)

24.Për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë e të komandës unike në ushtri, 21 dhjetor 1954. (Vep.12, f.196-205)

25.Vendimet e Partisë duhet të udhëheqin çdo ditë dhe çdo orë gjithë veprimtarinë e organevet të punëvet të brendshme, 4 mars 1955. (Vep.12, f.237-248)

26.Mbi sistemimin në punë të ushtarakëvet të çmobilizuar, 29 tetor 1955. (Vep.13, f.80-82)

27.Letër drejtuar oficerëvet të forcavet të armatosura të RPSH-së që kalojnë në rezervë, 8 nëntor 1955. (Vep.13, f.83-89)

28.Kuadrot e organevet të punëvet të brendshme të jenë shokë lufte e pune, komunistë të mirë, me kulturë të lartë e moral të pastër, 5 janar 1956. (Vep.13, f.120-128)

29.Nga fjala në takimin me ushtarakët shembullorë, 11 maj 1957. (Vep.14, f.380-391)

30.Letër dërguar organizatavet të Partisë në terren dhe në ushtri, në lidhje me arratisjen e Panajot Plakut, 17 maj 1957. (Vep.14, f.448-449) (Në këtë letër P.Plaku cilësohet si agjent i hershëm i jugosllavëvet, i cili ish kamufluar me mjeshtëri, deri sa kish arritur në pozita të larta ushtarake… Në kohën tonë gëlojnë nëpër Tiranë gjithfarë agjentësh, "***zgjidhen***" në kryesi të partivet, arrijnë deri në qeveri, dhe s'u hyn ferrë në këmbë. Gj.D.)

31.Letër ngushëllimi dërguar në emër të Komitetit Qendror, prindërvet të ushtarit Gor Trifoni, 25 maj 1957. (Vep.14, f.456-457)

32.Disa detyra për forcimin e punës së Partisë në ushtri, 10 maj 1958. (V ep15, f.411-414)

33.Të rritet gjithmonë e më shumë roli udhëheqës i Partisë në ushtri, 5 tetor 1958. (Vep.16, f.178-180) (Jam kurioz të di: Ç'do të mendonte një ushtarak i sotëm lidhur me këto direktiva të Enver Hoxhës, të vitit 1958? "***Roli udhëheqës***" i cilës parti do të pëlqehej? Apo s'ka nevojë për kurrfarë roli udhëheqës, sepse ushtria "***udhëheq***" vetëveten?! Gj.D.)

34.Të forcohet puna e Partisë në repartet e kufirit, 24 dhjetor 1958. (Vep.16, f.444-446) (Ja edhe një tjetër çudi! Repartet e kufirit! Paska pasë RPSH-ja ushtarë që ruanin kufirin! A thua mund të kalonin, fara e drogës dhe thasët me drogë, në atë kohë, nëpër kufirin e atij shteti?! Gj.D.)

35.Letër organizatës së BRPSH-së të repartit ushtarak nr.217, 23 tetor 1959. (Vep.17, f.347-353)

36.Fjala në Shkollën e Bashkuar të Oficerëvet "Enver Hoxha", 8 nëntor 1959. (Vep.17, f.394-404)

37.Partia në ushtri kërkon disiplinë të ndërgjegjshme, 18 dhjetor 1959. (Vep.17, f.518-520) (Pra, jo disiplinë të verbër, siç ndodh sot në ushtrinë tonë mercenare: „***Pse jam ushtar unë?!.. Jam ushtar, për të ruajtur paqen në botë***! ***I shërbej Atdheut si paqeruajtës përtej Urës së Qabesë***!" Ndërsa në Atdheun e tij shkatërrohet edhe qendra e fundit e zjarrit dhe bunkeri i fundit, me vare e me çekan, „***se nuk i duhen më askujt, se Atdheu i tij s'ka më rrëzik të sulmohet prej askujt!***" Gj.D.)

38.Repartet xhenire të punës të përgatitin njerëz me profesione të ndryshëm, 18 prill 1960. (Vep.18, f.202-203)

39.Organizatat e Partisë në kufi të jenë të forta, të pastra, monolite, 25 prill 1960. (Vep.18, f.204-226)

40.Të kalitim kurdoherë kuadrot e Ministrisë së Punëvet të Brendshme, 25 mars 1961. (Vep.20, f.364-365) (Ministria e Punëvet të Brendshme ishte një sektor që

sulmohej shumë prej agjentuarave të huaja, sepse pikërisht ajo armë ua prishte punët të huajvet. Gj.D.)

41.Edhe pa Bazën e Vlorës ne do të luftojmë, 1 prill 1961. (Vep.20, f.377-385) (Ishte koha kur forcat ruse duhej të largoheshin nga Baza e Vlorës, por nuk dihej si do të përfundonte operacioni, pasi Rusia ish një superfuqi dhe e kish të domosdoshme një bazë ushtarake në brigjet e Mesdheut, përballë superfuqivet perendimore. Gj.D.)

42.Anije luftarake të Flotës Amerikane në portet e Jugosllavisë, 8 prill 1961. (Vep.20, f.386-390)

43.Ushtria jonë është një garanci për të mbrojtur fitoret e arritura, 8 maj 1961. (Vep.21, f.60-72)

44.Uniteti Parti-popull e bën RPSH-në një kështjellë të pamposhtur, 9 maj 1961. (Vep.21, f.73-83)

45.Kush përpiqet t'i bëjë varrin Shqipërisë, do bjerë vetë brenda, 9 maj 1961. (Vep.21, f.99-115) (Është koha kur do të zhvillohej gjyqi i grupit të Teme Sejkos. Enveri bën fjalë aty për një komplot shumëpalësh kundër RPSH-së. Është thënë më vonë sikur ai komplot nuk ka ekzistuar. Është folur për njëfarë infiltrimi të Teme Seikos dhe pastaj për prerje në besë. Dihet që infiltrimet në zbulimet e huaj i ka përdorur Enver Hoxha, përndryshe nuk mund të përballohej histeria e rrënuesvet të Shqipërisë. Shembull është Pal Mëlyshi, po edhe dhjetëra raste të tjerë, ku ***Sigurimi Shqiptar*** ka dalë fitues. Kështu që edhe infiltrimi i Teme Seikos mund të hamendet si i mundshëm, por e vërteta kryesore, thelbi i së vërtetës, tashmë është dëshmuar katërcipërisht dhe krej lakuriq. Ndaj shtetit shqiptar, ndaj RPSH-së dhe më vonë RPSSH-së, po edhe ndaj krejt Kombit Shqiptar, ka pasur dhe ka KOMPLOTE SHUMËPALËSH. Shkatërrimi i krejt bujqësisë, shkatërrimi i krejt industrisë, hapja e depovet të armatimit, asgjësimi i krejt arsenalit ushtarak, sidomos në vitin 1997, zhvlerësimi në Republikën e Kosovës i të gjitha meritave të UÇK-së, mosvënia në jetë e së quajturës ***Marrëveshje të Ohrit***, që është minimumi i të drejtavet që duhet t'u jepen shqiptarëvet, mos'hapja qoftë edhe e një shkolle shqip në Tivar, minimi nga themelet i krejt traditës sonë shumëshekullore kombëtare në Malësinë e Madhe dhe në Plavë e Gusi, moslejimi i së drejtës as për t'u quajtur shqiptar në Çamërinë e Teme Seikos, e gjithë kjo dëshmon se ka pasur

në vitin 1961 dhe ka edhe sot një KOMPLOT SHUMËPALËSH dhe shumëdimensional kundër shqiptarëvet. Gj.D.)

46.Mbrojtja e kufijvet është detyra më e lartë patriotike, 2 qershor 1961. (Vep.21, f.161-193)

47.Aviatorët që rriti, kaliti dhe edukoi Partia, janë bij besnikë të saj dhe të popullit, 15 qershor 1961. (Vep.21, f.256-264) (Populli shqiptar i kujton tani ata aviatorë me mall e krenari, por edhe me dhimbje të pafundme, se s'kemi më as avionë e as aviatorë. Paguajmë miliona për një helikopter në Francë dhe ai na rrëzohet midis malevet, pa arritur të dalë nga Franca. Na digjen pyjet dhe s'i kemi pesë helikopterë, për të shuar zjarret. Ishim mësuar t'i shihnim avionët tanë tek stërviteshin! I mbanim sytë në qiell gjithë krenari e lumturi. Sot fluturojnë mbi shtëpitë tona vetëm avionët e huaj të pasagjerëvet, të cilët na e thajnë xhepin kur duam të udhëtojmë diku. Gj.D)

48.Mbledhjet e organizatavet bazë të Partisë në ushtri të jenë luftarake, 23 tetor 1961. (Vep.22, f.62-64)

49.Të ruhet e të mirëmbahet me kujdes makineria ushtarake, 23 tetor 1961. (Vep.22, f.65-66)

50.Të ecim përpara pa e hequr pushkën nga krahu, 11 nëntor 1961. (Vep.22, f.208-216)

51.Vigjilencën ta kemi në rendin e ditës, armët t'i mbajmë gati dhe barutin të thatë, 14 nëntor 1961. (Vep.22, f.255-283)

52.Stërvitjet ushtarake fuqizojnë aftësinë mbrojtëse të Atdheut tonë, 7 dhjetor 1961. (Vep.22, f.407-424)

53.Të jemi vigjilentë, të qartë politikisht dhe të armatosur kundër armiqvet të jashtëm dhe të brendshëm, 15 janar 1962. (Vep.23, f.27-44) (Sot s'kemi armiq të jashtëm! As armiqtë e brendshëm nuk ekzistojnë. Jemi një komb i lumtur! Eldorado! Nuk vjedhim njëri-tjetrin, nuk vritemi njëri me tjetrin, kompanitë e huaja, të naftës, të minieravet, deri edhe të quajturit fasonë, punojnë vetëm për ne. Gj.D.)

54.Të forcohet puna mësimore, edukative dhe pedagogjike në shkollat ushtarake, 4 maj 1962. (Vep.23, f.278-281)

55.Puna ideopolitike në ushtri do të bëjë që ajo të jetë kurdoherë në gatishmeri edhe nga ana ushtarake, 22 tetor 1962. (Vep.23, f.502-506)

56.Ne nuk do të mbetemi kurrë pa bukë e pa armë, 28 tetor 1962. (Vep.23, f.571-587) (Mbas vitit 1990 mbetëm edhe pa bukë, edhe pa armë. Miellin po e importojmë nga Sërbia, qoftë edhe me substanca kancerogjene. Armët, topat dhe tanket, i kemi çuar në ***Zhelezarën*** e Nikshiqit. Kushedi kush i ka marrë paratë e atij metali! Gj.D.)

57.Organizata e Partisë në ushtri duhet të jetë një bërthamë e çeliktë, 5 shkurt 1963. (Vep24, f.180-212)

58.Arma e Sigurimit është dora e çeliktë e popullit që ndërton socializmin, 19 mars 1963. (Vep.24, f.325-329)

59.Buka dhe fishekët të mos na mungojnë asnjëherë, 21 tetor 1963. (Vep.25, f.444-482) (Shumë nga librashkruesit tanë të sotëm, të mençurit mbi të mençur, thonë që Enver Hoxha s'ka menduar kurrë për popullin. Gj.D.)

60.Puna e Partisë në ushtri luan një rol vendimtar, 25 mars 1964. (Vep.26, f.181-184)

61.Vendimet historikë të Kongresit të Përmetit dolën nga gryka e pushkës partizane, 24 maj 1964. (Vep.26, f.419-447)

62.Të jemi të përgatitur për të përballuar çdo agresion të mundshëm armik, 20 qershor 1964. (Vep.27, f.57-61)

63.Partia kërkon që populli dhe ushtria të jenë të qartë politikisht dhe të përgatitur ushtarakisht, 30 tetor 1964. (Vep.28, f.68-80)

64.Kufitarët trima janë kurdoherë në mbrojtje të Atdheut tonë socialist, 25 prill 1965. (Vep.29, f.392-395)

65.Mbrojtja dhe zbatimi i ligjevet, detyrë e shenjtë e Policisë Popullore, 14 maj 1965. (Vep.29, f.561-564) (Sot „***detyrë e shenjtë***" e një shumice policësh është, t'i zhvatë ndonjë lek drejtuesit të makinës, edhe kur ai s'ka bërë asnjë shkelje. Gj.D.)

66.Pushka, pena dhe politika na duhen kurdoherë, 23 maj 1965. (Vep.30, f.1-33)

67.Puna politiko-ushtarake bëhet më mirë në grupe të vegjël njerëzish, 19 tetor 1965. (Vep.30, f.359-362)

68.Ushtria është shkollë, 7 janar 1966. (Vep.31, f.15-31)

69.Të kalitim fizikisht popullin për mbrojtje, 20 janar 1966. (Vep.31, f.137-147)

70.T'u drejtohemi me një letër të hapur, gjithë Partisë, gjithë popullit dhe gjithë ushtrisë, 8 shkurt 1966. (Vep.31, f.229-239) (Enveri në këtë parashtresë ka folur për heqjen e gradavet në ushtri dhe për uljen e pagavet të larta, me synimin që ato t'u afrohen pagavet të mesme dhe të ulëta. Sado që ideja e tij ishte tepër humane, për të arritur te njerëzit një barazi, të themi absolute, unë mendoj që një barazi e tillë ishte dhe është pamundur. Prandaj njerëzimit do t'i duhet të kërkojë rrugë më racionale, gjithsesi pa i lënë mënjanë as humanizmin, as synimin që njerëzit ta ndiejnë veten mirë në ambientet ku jetojnë. Gj.D.)

71.Ushtritë revolucionare i bën të forta marksizëm-leninizmi, 5 mars 1966. (Vep.31, f.365-384) (Do të vijë një kohë që njerëzimi t'i rikthehet marksizëm-lininizmit, për ta studiuar atë me themel dhe për të marrë prej asaj teorie e përvoje ÇDO GJË TË MIRË. Madje, ndoshta do të ish më mirë të thuhet: Për të korrigjuar ato pak gjëra që ajo teori e praktikë s'i kish ashtu si duhej dhe për të shtuar ato që asaj i mungonin. Gj.D.)

72.Forca e ushtrisë sonë qëndron te populli dhe te udhëheqja e Partisë, 27 prill 1966. (Vep.32, f.108-155)

73.Ta bëjmë të gjithë Atdheun mburojë të pakapërcyeshme për armiqtë, 28 prill q966. (Vep.32, f.156-169)

74.Partia na mëson të punojmë ushtarakisht, 1 qershor 1966. (Vep.32, f.387-419)

75,Të mendojmë e të veprojmë kurdoherë si revolucionarë, 2 qershor 1966. (Vep.32, f.420-450)

76.Lufta e armatosur, e vetmja rrugë e popullit që dëshiron lirinë dhe pavarësinë e tij, 18 qershor 1966. (Vep.33, f.51-62)

77.Kundërrevolucioni do të shkatërrohet vetëm me revolucion dhe jo duke bërë kompromise me imperialistët apo me revizionistët, 20 qershor 1966. (Vep.33, f.63-70) (Unë nuk besoj që, në rrethanat e një armatimi kaq të lemerishëm bërthamor, në rrethanat kur armët bakteriale dhe kimike janë edhe më të lemerishme se vetë armët bërthamore dhe në rrethanat e një roli përherë e më të frikshëm të kibernetikës, kur propaganda e ka kretenizuar dhe, të thash, idiotizuar mendjen njerëzore, revolucionet e tipit të shekujvet XIX e XX janë të mundshëm. Njerëzimi duhet të kërkojë rrugë të tjera për ta mposhtur regresin dhe për të hyrë përfundimisht në një rrugë progresi më të sigurt dhe më afatgjatë. Gj.D.)

78.Ushtria te ne është e lidhur ngushtë me Partinë e me popullin dhe mëson vazhdimisht prej tyre, 11 korrik 1966. (Vep.33, f.176-181)

79.Problemet e organevet të punëvet të brendshme nuk qëndrojnë jashtë drejtimit e kontrollit të Partisë, 23 shkurt 1967. (Vep.35, f.77-88)

80.Ta bëjmë Ushtrinë Popullore shkollë të madhe revolucionare, politike dhe ushtarake, 27 shtator 1967. (Vep.36, f.410-423)

81.Të sjellim gjak të ri në organet e punëvet të brendshme, 11 nëntor 1967. (Vep.37, f.34-38)

82.Ushtria jonë është armë e dashur dhe e fuqishme e popullit, 10 korrik 1968. (Vep.38, f.449-467)

83.Në ushtri mbi të gjitha është kontrolli i Partisë, 19 shtator 1968. (Vep.39, f.86-92)

84.Ushtria jonë është armë e pamposhtur e Partisë, 16 tetor 1968. (Vep.39, f.144-147) (Në kohën tonë, në sistemet e sotëm shumëpartiakë, duket sikur të gjitha këto janë thënë e shkruar jo 50 vjet më parë, por kushedi sa shekuj dhe kushedi në cilin planet. Por pyetja shtrohet: A është më mirë kështu? Kush e kontrollon sot ushtrinë e një shteti? Partia që ka fituar zgjedhjet. Partia që ka pushtetin. Po nesër, kur të fitojë një parti tjetër, ç'duhet të ndodhë në kokën e një ushtaraku?! Revolicion?! Ndryshim bindjesh?! Apo do të duhet të sillet oficeri siç „***sillet***" një veturë kur kalon nga një pronar te tjetri?! Gj.D.)

85.Partia kërkon përpikëri në kryerjen e detyravet luftarake, 25 shkurt 1969. (Vep.40, f.145-149)

86.Presionet ushtarakë, bazë e diktatit dhe e shantazhit politik të udhëheqësvet revizionistë sovjetikë, 11 prill 1969. (Vep.40, f.401-415) (Është një artikull, botuar në „ ***Zërin e popullit"*** kundër ndërhyrjes ushtarake të Bashkimit Sovjetik në Çekosllovaki. Gj.D.)

87.Puna politike në ushtri të ngrihet në një nivel më të lartë, 5 maj 1969. (Vep.41, f.11-18)

88.Të jemi të armatosur me armë, të ngritur politikisht dhe të mobilizuar në punë, 29 maj 1969. (Vep.41, f.216-243)

89.Kufitarin ta edukojmë kurdoherë me frymën dhe me displinën e rreptë të Partisë, 12 shtator 1969. (Vep.41, f.449-456)

90.Shkollat ushtarake t'i kalitin kuadrot nga çdo pkëpamje, 15 janar 1970. (Vep.42, f.336-345) (Kush i kujton ato shkolla, me djem aq të mrekullueshëm, s'ka si të mos mbushet me mall e dëshirë që Kombi ynë të ketë sërish të tilla fidanishte të atdhetarizmit. Unë kam pasur në fakultet 4-5 shokë që kishin dalë nga ajo shkollë. Ishin dhe kanë mbetur njerëz të mrekullueshëm. Gj.D.)

91.Polici është njeri i Partisë dhe aktivist shoqëror, 16 janar 1970. (vep.42, f.369-374) (Erdhi një kohë që polici të bëhet njeriu më i bezdishshëm, më i papëlqyeshëm dhe skajisht i parespektueshëm. Gj.D.)

92.Teza për Shkollën e Lirë Ushtarake, 5 mars 1970. (Vep.43, f.1-16) (Shkolla e Lirë Ushtarake, SHLU, ishte një institucion gjithpërfshirës për edukimin ushtarak të popullit, veçanërisht të vajzavet dhe gravet që nuk bënin ushtri të rregullt. Gj.D.)

93.Ushtrinë dhe popullin t'i edukojmë mirë politikisht e ushtarakisht, 29 maj 1970. (Vep.43, f.321-325)

94.Çdo gjë ta bëjmë me frymë revolucionare, 16 tetor 1970. (Vep.44, f.316-318)

95.Udhëheqja e Ministrisë së Mbrojtjes të analizojë mirë gjendjen e krijuar në dikaster, 26 tetor 1970. (Vep.44, f.359-378) (Megjithatë, kish filluar, siç shihet,

degradimi i kastës udhëheqëse dhe komanduese të ushtrisë. Ky ishte dhe do të mbetej një ndër shqetësimet më të mëdhenj të Enver Hoxhës. Gj.D.)

96.Drejtuesit e Ministrisë së Mbrojtjes janë përgjegjës direktë për gjendjen në ushtri dhe duhet të përgjigjen para Partisë, 8 dhjetor 1970. (Vep.45, f.26-57)

97.Aviatori me avionin janë një e të pandarë, 24 prill 1971. (Vep.46, f.69-86)

98.Atdheu është i gjithë popullit, prandaj duhet të mbrohet nga i gjithë populli, 1 korrik 1971. (Vep.46, f.374-406) (Sot, një shumice njerëzish do t'u dukej çudi t'u thuhej kështu. Ndërsa pjesa tjetër, shumica më e madhe, do të donte ta mbronte Atdheun, por si? Kush e organizon? Kush e stërvit? Ku t'i marrë armët? Sot populli s'ka asgjë në dorë, veç faqevet të fejzbukut, ku s'pushon së adhuruari flamurin dhe gjuhën e vet. Gj.D.)

99.Të forcohet më tej bashkëpunimi ushtri-terren, 27 mars 1972. (Vep.48, f.314-324) (Ç'do me thënë ***terren*** për ushtrinë tonë të sotme, mbyllur nëpër kazerma, në mos ndonjë pastrim territori prej mbeturinavet plastike?! Gj.D.)

100.Larg duart nga Ballkani, 29 mars 1972. (Vep.48, f.320-324) (Është sërish një artikul i botuar në "***Zërin e popullit***", i cili flet për lëvizjet diplomatike dhe ushtarake të Bashkimit Sovjetik në disa shtete të gadishullit tonë… Mbas vitevet 1990, Iliriku, që mua s'më pëlq en ta quaj Ballkan, sepse është një emër që ia kanë vënë turqit osmanë, u shndërua sërish në një fuçi të plasaritur baruti, mbërthyer gjithandej dërrasash të kalbura: Në Beograd, në Shkup, në Tiranë, në Podgoricë, në Prishtinë, në Sarajevë. Një fuçi dërrasash të kalbura, rreth së cilës s'pushojnë së vërdallosuri emisarët e një Rusie, e cila është e detyruar ta eksportojë krizën ekonomiko-sociale në çfarëdolloj mënyre, e mënyra më e mirë është ajo që e kanë përdorur carët e dikurshëm. Gj.D.)

101.Forcimi i lidhjevet të shëndosha të popullit me ushtrinë, garancia për mbrojtjen e Atdheut, 20 prill 1972. (Vep.48, f.354-358)

102.Partia jonë punon që Atdheun ta mbrojë jo vetëm ushtria, por tërë populli ushtar, 13 tetor 1972. (Vep.49, f.381-393) (Një popull i shkapërderdhur tashmë në gjithë botën! Më mirë të mos e përfytyrojmë, se do të na vijë të themi si Fan Noli dikur: "***Më jep një spec djegës, ta përvëloj këtë xhan***!" Gj.D.)

103.Puna ideologjike e kulturore në ushtri t'i shërbejë mbrojtjes së Atdheut, 19 janar 1973. (Vep.50, f.30-78)

104.Të gjitha forcat e popullit ushtar të jenë kurdoherë në gatishmeri të plotë, 23 janar 1973. (Vep.50, f.116-130) (Shko gjeje sot popullin ushtar: ditën nëpër kafenera, natën në pabe dhe nëpër motele! Gj.D.)

105.Mbani kurdoherë lart flamujt luftarakë, qëndroni vigjilentë, të gatshëm, të vendosur e të bashkuar, 9 korrik 1973. (Vep.52, f.1-9)

106.Partia na mëson të punojmë, të krijojmë, të vigjilojmë dhe të mbrojmë, 16 tetor 1973. (Vep.52, f.223-228)

107.Rinia e vendit tonë është e luftës dhe e punës, e pushkës dhe e këngës, 16 tetor 1973. (Vep.52, f.236-243) (U ndodha një ditë në njërin prej qytetevet tanë të vegjël. Nxënësit e një shkolle të mesme dolën në pushim dhe vrapuan drejt breglumit. „***Ku po shkojnë***?!", pyeta. „***Shkojnë për të pirë hashash***!" m'u përgjigj banori që e pyeta. „***Shumica rrinë andej dy a tri orë dhe prej andej shkojnë në shtëpi. Prindët mendojnë se i kanë pasur në shkollë***." Gj.D.)

108.Populli ynë nuk e ka ndarë kurrë „dyfekun me gjalm" nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën nga puna, 9 nëntor 1973. (Vep.52, f.255-269)

109.Njësitë vullnetare të popullit të mësojnë mirë taktikën e luftës partizane, 28 mars 1974. (Vep.52, f.327-333)

110.Veprimtari e rrëzikshme dhe armiqësore e Beqir Ballukut, 2-3 korrik 1974. (Vep.53, f.1-45) (Enveri, si përherë, do ta godiste në kokë tendencën kazermiste të myteberëvet të rinj, në mënyrë që të ruhej e shëndoshë masa atdhedashëse dhe rinore e ushtrisë. Gj.D.)

111.Ushtri e vërtetë e popullit, ushtri e revolucionit ngadhnjimtar, 10 korrik 1974. (Vep.53, f.46-48)

112.Letër për veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut, 29 korrik 1974. (Vep.53, f.115-127)

113.Ushtria jonë është ushtria e Partisë, me norma, me ligje dhe me ideologjinë marksiste-leniniste, 10 tetor 1974. (Vep.53, f. 182-193)

114.Të spastrojmë me fshesë të hekurt veprimtarinë armiqësore të Beqir Ballukut, të nxjerrim mësime për forcimin e mëtejshëm të punës së Partisë në ushtri, 14 tetor 1974. (Vep.53, f.194-305) (Kemi rastin këtu të ndalemi pak te shprehja "***fshesë e hekurt***". I janë bërë akuza mbas akuzash Enver Hoxhës. E unë po pyes fare shkurt: Veprimi me armë kimike mbi fëmijët e Sirisë, a s'është ***fshesë hekuri*** mijëfish më e egër?! Kundërveprimi i ushtrisë amerikane "***për të ndëshkuar përdoruesit e atij helmi***", a s'është prapë një ***fshesë e hekurt***?! Gj.D.)

115.Mbi një letër "autokritike" që më dërgon Petrit Dimja, 17 teztor 1974. (Vep.53, f.314-316)

116.Edhe njëherë për Shkollën e Lirë Ushtarake, 22 nëntor 1974. (Vep.53, f.123-326)

117.Si duhet të funksionojnë organizatat e Partisë në ushtri, 26 nëntor 1974. (Vep.53, f.349-362)

118.E gjithë Partia, populli dhe ushtria dënuan njëzëri tradhtarët, 16 dhjetor 1974. (Vep.53, f.395-407)

119.Të thellojmë më tej analizën e komplotit të Beqir Ballukut, Petrit Dumes, Hito Çakos dhe të nxjerrim mësime për punën e Partisë në ushtri e në terren, 17 dhjetor 1974. (Vep.53, f.408-516)

120.Ngjarjet që na ndodhën në ushtri, t'i shohim të lidhura ngushtë me detyrat për realizimin e planit, 26 dhjetor 1974. (Vep.54, f.63-74)

121.T'i futemi thellë studimit të teorisë së artit ushtarak, 9 janar 1975. (Vep.54, f.75-100)

122.Strumbullari në ushtri është Partia, 5 mars 1975. (Vep.54, f.238-244) (Porosi shumë herë e përsëritur, dëshmi që këtij parimi i kushtohej kujdes i vazhdueshëm. Gj.D.)

123.Në ushtri duhet të ekzistojë më tepër se kudo gjetkë një disiplinë e hekurt, 15 maj 1975. (Vep.54, f.367-381)

124.Puna armiqësore në ekonomi është e bashkërenditur me veprimtarinë armiqësore në ushtri dhe në ideologji, 30 maj 1975. (Vep.54, f.494-498) (Tashmë,

kasta e administratës së degraduar i kish përfshirë të gjithë sektorët shtetërorë. Enveri do të përpiqej të bënte spastrime, por e gjithë përpjekja e tij do të rezultonte e kotë, jo më shumë se dhjetë vjet më vonë. Bie në sy këtu pohimi i tij që "***puna armiqësore***" është shtrirë edhe në IDEOLOGJI. Në të vërtetë, vetë ideologjia marksiste-leniniste, ashtu siç ish zbatuar deri atëherë, sado që ish një ideologji progresiste, po manifestonte defekte të rëndë. Nuk mund të shpjegohet ndryshe dështimi i asaj ideologjie në shkallë botërore e, më në fund, edhe në RPSSH, me gjithë këmbënguljen, tepër të arsyeshme, të Enver Hoxhës. Them ***tepër të arsyeshme***, sepse kam bindjen që Enveri e dinte ç'katrahurë do të sillte këtu restaurimi, kthimi prapa te ato ideologji që e patën mbajtur Kombin tonë në errësirë e në mjerim shekuj me radhë. Gj.D.)

125.Të punojmë, të prodhojmë e të forcojmë mbrojtjen, që kufijtë tanë të jenë gjithmonë të paprekshëm, 29 prill 1976. (Vep.57, f.305-313) (Fatkeqësisht, kufijtë e RPSSH-së u bënë përsëri, edhe të prekshëm, edhe të shkelshëm, edhe mizorisht të copëtueshëm, edhe pa ndërprerë të kërcënuar. Mund të kujtojmë këtu një „***komunikatë***" të Manush Myftiut, që "***tash e tutje kalimi i kufirit nuk do të konsiderohet tradhti ndaj Atdheut***". Fill mbas një të tillë "***liberalizimi kapitalist***", turma shqiptarësh që niseshin për të kërkuar "***jetë më të mirë***" e që e dimë tashmë ç'jetë kanë gjetur. Iknin andej nga s'kish pika doganore dhe i kthente policia greke, me tufa, në pikat doganore. Midis njerëzish të ndershëm, gjithfarë llumi, që e villte Atdheu ynë, siç villet një gjellë prishur: trafikantë fëmijësh, trafikantë femrash, trafikantë droge, trafikantë armësh, trafikantë objektesh arkeologjikë, trafikantë ikonash… Mund të kujtojmë këtu edhe të atilla "***prekje***" të kufijvet tanë, si "***marrëveshja***" për detin me Greqinë, se pak tokë e det na kish marrë Greqia! Gj.D.)

126.Në ushtri të mos veprohet kurrë formalisht, 29 maj 1976. (Vep.57, f.388-400)

127.Studentët ushtarakë të pajisen edhe me kulturë të përgjithshme, 1 qershor 1976. (Vep.58, f.1-5)

128.Fijet e komplotit çojnë edhe në Kinë, 21 shtator 1976. (Vep.58, f.211-221) (Doemos. Nuk kish si ndodhte ndryshe. Veçse këtu duhet të mbajmë parasysh edhe arsyen kryesore, simbas meje, pse Enver Hoxha u shkëput me aq vendosmeri prej Kinës. Kina nuk po i përkrahte kërkesat e shqiptarëvet të mbetur nën Jugosllavi.

Ne kishim pasur në ata vite kontakte me studentë kinezë dhe e kishim konstatuar me kohë këtë lloj qëndrimi antishqiptar në politikën e jashtme kineze. Atyre u pëlqente ta kenë mirë, "***jo vetëm me ne, por edhe me jugosllavët***". Gj.D)

129.Të sigurohet kurdoherë një bashkëpunim i përsosur midis terrenit dhe ushtrisë, 22 dhjetor 1976. (Vep.60, f.105-114)

130.Atdheu mbrohet jo vetëm kur përgatitemi ushtarakisht, por kur jemi të fortë edhe politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht, 21 mars 1977. (Vep.61, f.10-74)

131.Kush e do Atdheun, duhet të mësojë edhe ta mbrojë atë, 8 prill 1977. (Vep.61, f.155-164)

132.Çdo neglizhencë në stërvitje kushton shumë gjatë luftës, 28 prill 1978. (Vep.66, f.129-147)

133.Në ushtri nuk mund të ecet pa disiplinë, 21maj 1978. (Vep.66, f.221-226)

134.Të përgatitemi nga çdo pikëpamje për mbrojtje, që armiku të mos na zërë kurrë në befasi, 27 qershor 1978. (Vep.67, f.139-157)

135.Socializmin ta ndërtojmë pa harruar për asnjë çast mbrojtjen e popullit dhe të fitorevet të tija, 10 korrik 1978. (Vep.67, f.207-245)

136.Shkollat ushtarake janë shumë të rëndësishme për mbrojtjen e vendit, 10 korrik 1978. (Vep.67, f.246-252)

137.Të rrënjosim te kuadrot ndërgjegjen komuniste për forcimin e ushtrisë dhe mbrojtjen e Atdheut, 9 shkurt 1979. (Vep.69, f.314-334)

138.Të ruhemi nga euforia e pabazuar në vlerësimin e gjendjes në ushtri, 12 shkurt 1979. (Vep.69, f.335-341)

Kam shënuar këtu 138 titujt e gjithsej 1850 faqevet, në të cilat Enver Hoxha është marrë, midis tjerash, edhe me ushtrinë. Në krejt veprën e tij ka sigurisht shumë më tepër, por edhe kaq mjaftojnë për të kuptuar sa rëndësi i kushtonte ai çlirimit të Atdheut dhe mbrojtjes së Atdheut.

Ndonëse nuk është objekt i këtij parashtrimi, po ndalem pak edhe te libri "***Titistët***" i Enver Hoxhës. Aty, në afër 600 faqe libër, trajtohen edhe çështje të rëndësishme

ushtarake, që kanë të bëjnë me mbajtjen nën sundim të pjesëvet të Shqipërisë që regjimet monarkistë jugosllavë i kishin pushtuar, si dhe me synimet për të pushtuar edhe shtetin shqiptar. Mjafton të lexojmë vetëm disa nga nëntitujt e atij libri:

"***Një nga padrejtësitë më të mëdha të këtij shekulli në Evropë – më 1913 Shqipëria u nda arbitrarisht përgjysmë" … "Gjenocid sërbomadh në viset shqiptarë të Jugosllavisë në periudhën midis dy luftëravet."*** (f.3-18)

"Svetozar Vukmanoviq Tempoja në Shqipëri: 'Kam një ide që përfshin Jugosllavinë, Shqipërinë, Bullgarinë e Greqinë'" … "Çështja e Istrias dhe çështja e Kosovës" … "Konferenca e Bujanit e dhjetorit 1943" (f.19-118)

„Misioni ‚Stoiniq' në Shqipëri." ... „Majori sovjetik ‚na njeh' nëpërmjet Stoiniqit." .. „Tre hapat e ‚misionit' Stoiniq: i pari – largimi nga Shqipëria i Milladin Popoviqit; i dyti: - përçarja e Byrosë sonë Politike; i treti – përçarja e KQ të PKSH-së dhe gllabërimi i Shqipërisë." ... „Titoja, ndërmjetës i anglezëvet." (f.119-202)

„'Një shaka' midis Titos dhe mbretit Pavllo për ndarjen e Shqipërisë." (f.203-246)

„***Ftesë e papritur e Titos për të shkuar në Beograd." ... „Bisedimet zyrtarë midis delegacionit shqiptar dhe atij jugosllav. Shqyrtimi i çështjes së Kosovës e të visevet të tjerë shqiptarë nën Jugosllavi." ... „Politikë shfarosëse në Kosovë." ... „'Nash Tito' apo ‚Duçe a noi'?"*** (f.247-272)

"Titoja kërkon të kthejë 'Ballkanin federativ' në një 'fuqi' të përqëndruar në duart e tija." (f.323-358)

"Ftesë e Gj.Dimitrovit për të vizituar RP të Bullgarisë." … "Një ndalesë e shkurtër në Beograd." … "Koçi Xoxen e thërret në takim të fshehtë Rankoviqi." (f.359-384)

"Vërshim ushtarakësh jugosllavë në Tiranë." … "Nako Spiru insiston për vënien e Mehmet Shehut në krye të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë." … "Tezat ushtarake të Tempos." .. "Gjeneral Hamoviqi kërkon krijimin e një komande unike." … "Gjeneral Kupreshanini në Tiranë." ... „Titoja: ‚Ju lutem të

na jepni bazën në Korçë për një divizion.“‘ ... „Njoftim Stalinit për divizionin jugosllav.“ (f.385-458)

„Udhëtim incognito në Rumani dhe lidhje me tradhtinë e Titos. Takim me Andrei Vishinskin.” (f.459-520)

“Lufta kundër titizmit – domosdoshmëri historike.“ ... „Udhëheqja e Beogradit hedh në veprim llumin antishqiptar, kriminelët dhe diversantët.“ ... „Tradhtia hrushoviane në ndihmë të tradhtisë titiste.“ ... „Mehmet Shehu – një poliagjent i shërbimevet të fshehtë imperialisto-revizionistë.” … “Viti 1960. Mehmet Shehu me Titon, Randolf Çërçillin e Fulcin në transatllantikun ‘Kuin Elizabet“‘ ... „Në vitet 1970. Agjenturat perendimore dhe ajo titiste i japin urdhër Mehmet Shehut të hidhet në veprim.” … “Demonstratat në Kosovë e detyrojnë UDB-ën të sakrifikojë kartën e ‘shpresës së madhe’ në Shqipëri.” (f.521-583)

(Vo! Numrat e faqevet në kllapa janë të kapitujvet, jo të nëntitujvet. Gj.D.)

(“***Karta e shpresës së madhe***“, simbas Enver Hoxhës, ishte Mehmet Shehu. Sa i përgjigjen së vërtetës këta pohime të Enver Hoxhës, duhet t’i lihet historiografisë për t’i hulumtuar në të ardhshmen, por unë po sjell këtu një fragment të tekstit, sa për ta informuar shkurtimisht lexuesin. Gj.D.):

“Pikërisht në situata të tilla që zienin prej kohësh, në fillimin e vitit 1981 ngjanë demonstratat në Kosovë. Sërbomëdhenjtë dhe UDB-a jugosllave u alarmuan, dërguan ushtri dhe i shtypën demonstratat me tanke. U vranë e u plagosën me qindra njerëz. Shpërtheu një zjarr i rrëzikshëm për gjendjen e brendshme, tashmë të tronditur të Jugosllavisë, si nga krizat ekonomike, ashtu edhe nga ato politike. Bujë e madhe u bë në opinionin ndërkombëtar për këto masa të egra represive. (RPSSH-ja) mbajti qëndrim të hapur, sa të vendosur, aq edhe të urtë.

Jugosllavëvet, përveç shpifjevet që këto demonstrata ishin nxitur gjoja nga (RPSSH-ja), iu desh të merrnin masa të menjëhershme ‘për të diskredituar’ udhëheqjen ‘staliniane’ shqiptare, për të turbulluar e për të përmbysur gjendjen e shëndoshë në (RPSSH), si dhe për të çorientuar forcat patriotike-revolucionare në Kosovë.

I kërkuan agjentit të tyre, Mehmet Shehut, të vepronte. UDB-a jugosllave ishte në bashkëpunim me CIA-n dhe i dinte direktivat e kësaj për likuidimin e Enver

Hoxhës. Prandaj kërkuan nga Mehmet Shehu të dërgonte urgjent në Paris të shoqen. Demonstratat ndodhën në mars, kurse ajo në prill 1981 shkoi në Paris. Iu paraqit atje një i dërguar nga Çalamani (vetë Mugosha kishte vdekur, por ‚jetonte' misioni i tij agjenturor), dhe i dha helmin që duhej të përdornin imediatisht për Enver Hoxhën.

Mehmet Shehu... iu drejtua padronit të madh, CIA-s emerikane. Fiqret Shehu filloi të vizitojë kryeqytetet e Evropës, Vjenën, Stokholmin, Kopenhagën. Ajo u takua edhe në Stokholm, edhe në Danimarkë me përfaqësues të CIA-s, ku parashtroi mendimin e Mehmetit që të mos vepronte siç kërkonin jugosllavët, me nxitim, se nuk ishin përgatitur mirë; helmimin ose likuidimin fizik të Enver Hoxhës ta linin për në mars 1982… Përfaqësuesi i CIA-s u mor vesh me qendrën e tij dhe, në takimin e dytë, tani në Danimarkë, u dha miratimi për variantin e Mehmetit." ("***Titistët***", f.573-574)

Është krejtësisht e kuptueshme dhe është krejtësisht e arsyetueshme që, as çlirimi, as ruajtja e lirisë, e cilitdo vend në botë dhe në cilëndo kohë, nuk bëhen pa derdhur gjak. Prandaj edhe nuk ka kurrfarë kuptimi të merremi, as tani, as ndonjëherë tjetër, me psherëtima a me bubullima, sa armiq ka vrarë Enver Hoxha e sa i kanë mbetur pa vrarë, sa prej tyre e kanë bërë hak e sa e kanë ngrënë plumbin kot së koti. Liria nuk fitohet, as nuk ruhet pa derdhur gjak!

Në vend të atilla psherëtimave a bubullimave, është më mirë të shikohet dhe të vihet mirë në dukje, sa jetë fëmijësh e të rriturish u shpëtuan, sa fëmijë e të rinj u shkolluan, sa njerëzve iu sigurua punë dhe rrogë në regjimin e Enver Hoxhës, sa shqiptarë nuk u vranë ferrave në kohën e tij e sa u vranë e u copëtuan mbas vdekjes së tij, sa jetë shqiptarësh u kursyen pa u dalë zorrët e iu thyer kockat në rrëzime e përplasje makinash, sa shqiptarë shpëtuan pa zënë burgjet e Evropës e sa pasardhës të atyre shqiptarëve sot po bëjnë "histori" nëpër ata burgje.

Enver Hoxha pat krijuar një ushtri të fuqishme, të kompletuar me të gjithë llojet e armatimit të asaj kohe dhe të organizuar në mënyrën më të përparuar për kohën. LLOJET E ARMËVET që përbënin në atë kohë ushtrinë shqiptare, ishin: **KËMBËSORIA**, një armë e motorizuar në mënyrë bashkëkohore, e mbështetur fuqishëm nga njësi të blinduara dhe nga reparte tankesh (numri i tankevet i kalonte 2 mijët); **ARTILERIA**, tokësore e kundërajrore, pajisur edhe me armatim raketor të

kohës; **MARINA**, kompletuar me shumicën e anijevet lundrues të luftës, midis tyre, edhe me disa nëndetëse; **AVIACIONI**, me mbi treqind avionë lufte dhe me pilotë të stërvitur në mënyrë të shkëlqyer; **KIMIA**, me theksin sidomos te mjetet mbrojtës nga sulmet me armë kimike; **XHENJOJA**, e cila ish e specializur për të kryer të gjithë punimet e mbrojtjes e të fortifikimit; **NDËRLIDHJA**, pajisur me të gjithë mjetet e radio-telefonisë; **ZBULIMI**, lokacioni me radarë të kompletuar, si të gjitha ushtritë e gjysmës së dytë të shekullit njëzet; **SIGURIMI**, me të gjitha strukturat që i duheshin për të mos u zënë në befasi; **SHËNDETËSIA**, e shtrirë dhe efektive deri në njësinë më të vogël të ushtrisë; **PRAPAVIJA**: ushqimi, veshëmbathja, fjetja. Që të gjitha funksiononin në mënyrën më të rregullt.

Udhëhequr nga parimi ***gjithë populli ushtar***, në të gjithë territorin e RPSSH-së funksiononin njësitë vendore të armatosura, që organizoheshin dhe komandoheshin prej Shkollës së Lirë Ushtarake. Në ***NJËSITË VENDORE*** përfshiheshin të gjitha vajzat e gratë, të afta për luftë, si dhe bura të moshuar, që ishin ende të fortë dhe që mund të kontribonin me njohuritë e tye ushtarake. Uniformat dhe armët e njësivet vendore mbaheshin në magazina të veçanta dhe përdoreshin vetëm në raste stërvitjesh, si dhe kur jepej alarmi. Në të gjitha shkollat e mesme zhvillohej si lëndë mësimore ***EDUKATA USHTARAKE***. Atë lëndë e zhvillonte komandanti ushtarak, oficer, i cili ishte njëkohësisht edhe nëndrejtor i shkollës. Armatimi, uniformat dhe pajisjet e tejra, mbaheshin në magazina të veçanta pranë shkollavet. Në universitete, ku përfshiheshin të gjithë studentët dhe pedagogët, nga 1967-a e në vazhdim, kanë funksionuar ***BRIGADAT USHTARAKE STUDENTORE,*** armatosur kryesisht me automatikë kallashnikov, por edhe me lloje të tjerë armatimi. Studentët, vajza dhe djem, kryenin rregullisht stërvitje ushatarake dhe në fund merrnin titullin e oficerit.

Në këtë mënyrë, praktikisht, të gjithë shtetasit e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ishin të stërvitur për luftë mbrojtëse dhe të armatosur një për një.

Krejt ajo ushtri kish karakter mbrojtës dhe vetëm në rast se do të sulmohej, do kalohej në kundërmësymje, me qëllim asgjësimin deri në fund të armikut sulmues. Pikërisht për ta realizuar mbrojtjen me sa më pak humbje, në krejt RPSSH-në një system fortifikimi nga më të përsosurit. Vetëm qendra zjarri, pika praktikisht të papushtueshme, përveçse me tradhti, ishin ndëtuar mbi pesëqind mijë. Secili fshat dhe secia lagje a bllok banesash qyteti, kish strehimin e vet të nëndheshëm.

Tingëllon tepër naive, kur dëgjojmë tutje-tëhu një frazë qesharake: "***Enver Hoxha kish hallin e vet***". A për vete i ndërtoi gjysmë milioni bunkerë Enver Hoxha?! Ai e dinte se do të vdiste një ditë. A për të mbrojtur kokën e vet e ngriti gjithatë ushtri Enver Hoxha, apo t'u krijojë kushte shqiptarëvet për ta mbrojtur vendin e vet edhe pasi ai të mos ish më i gjallë?! Është e pathemeltë përpjekja për t'i përafruar Stalinin, Enverin etj., me Hitlerin e Musolinin. Është gjithashtu e pambështetur thënia që „***Enveri i kish shndërruar shqiptarët ne skllevër***", sepse në RPSSH nuk kish skllavopronarë, që të shfrytëzonin punën e skllevërvet. Aty ku s'ka skllavopronarë, nuk ka si të ketë skllevër. Më vonë, një pjessë e shtresës burokratike synoi të kthehet në shfrytëzuese dhe ajo e realizoi qëllimin vetëm mbas vitit 1990.

Sapo t'i kenë lexuar këto pesë-gjashtë fjali, **KEQDASHËSIT** dhe, mbas tyre, **GJITHË BOTA JONË E CEKËT MENDËRISHT**, do të mundohen, jo t'i pranojnë këto që u thanë, por t'i hedhin poshtë me "***argumente***" edhe më të zbrazët, duke kërkuar në realitetin e atëhershëm gjithfarë pretekstesh, kleçkash, siç thotë populli, vetëm e vetëm për ta denigruar atë kohë qartësisht progresive.

Gjokë Dabaj, Durrës 4-20 prill 2017